

VENDIM
Nr.48, datë 27.1.2004

**PËR PËRZGJEDHJEN E TENDERUESIT TË PREFERUAR PËR REALIZIMIN E
KONTRATËS KONCESIONARE PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
"NËNË TEREZA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të vendimit nr.479, datë 31.8.2000 të Këshillit të Ministrave "Për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në Aeroportin e Rinasit", i ndryshuar, të pikës 1/b "Instruksionet për tenderin" të vendimit nr.352, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit dhe të dokumentacionit të projektit për realizimin e kontratës së koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për realizimin e kontratës koncesionare për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Tiranë, si më poshtë vijon:

- Konsorciumi Airport Partners me 89,8 pikë
- Konsorciumi VAK me 75,6 pikë

2. Në mbështetje të renditjes në pikën 1, Konsorciumi Airport Partners përzgjidhet si tenderuesi i preferuar.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, me cilësinë e OSHA-së, të fillojnë negociimet për nënshkrimin e kontratës së koncesionit me tenderuesin e preferuar. Në rast se negociatat me këtë tenderues nuk përfundojnë me sukses, OSHA rezervon të drejtën të fillojë negociimet me tenderuesin e dytë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano